



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË**

Nr. 1276/2 prot.

Tiranë, më 29.05.2023

NJOFTIM ME SHPALLJE

TË VENDIMIT NR. 1276, DATË 19.04.2023 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, "PËR ARKIVIMIN PAS VERIFIKIMIT TË ANKESAVE TË BASHKUARA TË PARAQITURA NGA SHTETASI Z. GRAMOZ BALLIU"

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesat e z. Gramoz Balliu me nr. 297 prot., datë 25.02.2020, nr. 297/1 prot., datë 09.03.2020, nr. 1330 prot., datë 24.06.2020, ndaj veprimtarisë së magjistratit z. E.Sh., prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë dhe me vendimin nr. 1276, datë 19.04.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për arkivimin pas verifikimit të ankesave të bashkuara të paraqitura nga shtetasi z. Gramoz Balliu", bazuar në nenin 122 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e ankesës. Vendim duhet t'i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë", Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Pogradec, Njësia Administrative "Proptisht" sipas adresës së lënë nga ankuesi: Fshati Slabinjë;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: www.ild.al.

Shpalljet që do të afishohen në ambientin e bashkisë përkatëse, do të hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

SEKRETAR I PËRERGJITHSHËM

Dëshira Pasko

